



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 shtator 2024
Nr. Ref.: RK 2541/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI92/24

Parashtrues

Reshad Zherka dhe Xhelal Zherka

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. Nr. 550/2023, të 17 nëntorit
2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Reshad Zherka dhe Xhelal Zherka, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktgjykimin [Pml. Nr. 550/2023], e 17 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [PN. nr. 1196/2022], e 20 janarit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [PK. Nr. 85/22], e 3 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit parashtruesit e kërkesës pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ-së).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 prill 2024, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën e tyre përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) e pranoi më 18 prill 2024.
6. Më 25 prill 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI. 92/24] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese, ndërsa përmes Vendimit [Nr. KSH. KI. 92/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 29 prill 2024, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
8. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesit e kërkesës parashtrojnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për herë të dytë, respektivisht, më parë parashtruan kërkesën KI06/16, i cili ka ndërlidhje të tërthortë me rrethanat e rastit konkret. Ndërsa, njëri prej parashtruesve, përkatësisht, parashtruesi R.ZH., parashtron kërkesë për herë të pestë, gjegjësisht, kërkesat KI90/21, KI138/22 dhe KI264/23.
10. Kërkesat e parashtruesit R.ZH. të parashtruara më 14 maj 2021 [kërkesa KI90/21], më 12 shtator 2022 [kërkesa KI138/22] dhe më 1 dhjetor 2023 [kërkesa KI264/23], respektivisht, nuk ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret. Përderisa, kërkesat KI90/21 dhe KI138/22 janë vendosur nga Gjykata, kërkesa KI264/23 ende nuk është vendosur.

11. Për aq sa është relevante, Gjykata rikujton se më 31 janar 2016, parashtruesit dorëzuan kërkesën e tyre të parë, të regjistruar në Gjykatë me numër KIO6/16, përmes së cilës kontestuan Aktgjykimin [Pml. Kzz 8/2015] e 18 shkurtit 2015 të Gjykatës Supreme, me ç'rast ishte refuzuar kërkesa e tyre për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me dënimin e tyre në procedurë penale, me pretendimin se ishte nxjerrë në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe paragrafët 1 dhe 2 të nenit 106 [Papajtueshmëria] të Kushtetutës. Gjykata në këtë rast vendosi se kërkesa ishte e papranueshme sepse ishte paraqitur jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesit e kërkesës përmes Aktgjykimit [P.nr. 346/12] të 23 majit 2013, të Gjykatës Themelore, ishin shpallur fajtor në bashkëkryerje për veprën penale "Ushtrim i ndikimit" nga paragrafi 1 i nenit 345 (Ushtrim i ndikimit) në lidhje me nenin 23 (Bashkëkryerja) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK), si dhe nxitjen e veprës penale "Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit" nga paragrafët 1 dhe 3 të nenit 339 (Shpërdorim i pozitës zyrtare ose i autorizimit) i KPPK-së në lidhje me nenet 23 (Bashkëkryerje) dhe 24 (Shtytja) të KPPK-së, dhe dënuar me dënim unik secili me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vitesh dhe 10,000 (dhjetë mijë euro) gjobë.
13. Më 6 qershor 2014, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR.nr.413/2013] ndryshoi Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore, duke ulur dënimin unik për parashtruesit e kërkesës nga kohëzgjatja prej 4 (katër) vitesh burgim, në kohëzgjatjen prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj.
14. Më 5 janar 2022, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për rishikimin e procedurës penale me arsyetimin se Aktgjykimi [PAKR.nr.413/2013], i 6 qershorit 2014, të Gjykatës së Apelit ishte mbështetur në dokument të falsifikuar dhe deklaram të rremë të dëshmitarit.
15. Në një datë të paspecifikuar, Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria Themelore) parashtrroi përgjigje në kërkesën për rishikim të procedurës, ku theksoi se kërkesa në fjalë është e pasafatshme sepse më 6 qershor 2016 janë bërë 2 (dy) vite nga plotfuqishmëria e Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
16. Më 11 maj 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PK.nr.85/2022] hodhi poshtë kërkesën e parashtruesve të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të gjykuar me Aktgjykimin [P.nr.346/12] e 25 majit 2013, të Gjykatës Themelore, të ndryshuar me Aktgjykimin [PAKR.nr.413/2013] të 6 qershorit 2014 të Gjykatës së Apelit, si të pasafatshme.
17. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër Aktvendimit [PK.nr.85/2022] të 11 majit 2022 të Gjykatës Themelore.
18. Më 10 qershor 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.589/2022] aprovoi ankesën e parashtruesve të kërkesës dhe anuloi Aktvendimin [P.K.nr.85/2022] të 11 majit 2022 të Gjykatës Themelore, duke e rikthyer çështjen për rivendosje në këtë gjykatë, me arsyetimin se kërkesa për rishikim të procedurës në rastin konkret nuk është e pasafatshme.
19. Më 3 nëntor 2022, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P.K.nr.85/22] refuzoi kërkesën e parashtruesve të kërkesës për rishikimin e procedurës penale të gjykuar me Aktgjykimin [P.nr.346/12] e 25 majit 2013, të Gjykatës Themelore, të ndryshuar me Aktgjykimin [PAKR.nr.413/2013] të 6 qershorit 2014 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës penale.

20. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan ankesë kundër Aktvendimit [P.K.nr.85/22] të 3 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore.
21. Më 20 janar 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN.nr.1196/2022] refuzoi ankesën e parashtruesve të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin [P.K.nr.85/22] e 3 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka refuzuar kërkesën e parashtruesve për rishikimin e procedurës penale, me ç'rast vlerësoi sërish se a janë përmbushur kërkesat ligjore për lejimin e përsëritjes së procedurës penale në rastin konkret.
22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesit e kërkesës parashtruan kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktvendimit [PN.nr.1196/2022] të 20 janarit 2023 të Gjykatës Themelore.
23. Më 17 nëntor 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr. 550/2023] refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesve të kërkesës, me arsyetimin se aktvendimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa nuk përmbajnë shkeljet për të cilat pretendohet. Më konkretisht, Gjykata Supreme në aktgjykimin e kontestuar, theksoi si në vijim:

“[...] provat që pretendohen se janë të reja në fakt nuk paraqesin prova të reja pasi që të njëjtat kanë qenë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, përkatësisht, kallëzimit penal.

[...]

“[...] pretendimet e theksuara paraqesin rrethana të cilat sipas pretendimeve mund të vënë në dyshim vendimmarrjen e gjyqtarëve që kanë vendosur çështjen kryesore mirëpo të cilat pretendime nuk janë të bazuara. Së pari sa i përket gjyqtarit [M.S.], gjyqtar i cili ishte vendosur këtë çështje në gjykatën e shkallës së parë dhe nga shkresat e kësaj çështje penale del se i njëjti kishte ushtruar detyrat e tij si gjyqtar në kuadër të misionit të EULEX-it në Kosovë dhe kushtet për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit janë shqyrtuar me rastin e përzgjedhjes së tij në këtë pozitë dhe nuk mund të kontestohen përmes këtij mjeti juridik, e që në të njëjtën linjë është edhe pretendimi tjetër i raporteve kolegjiale të gjyqtarës [E.S.] me gjyqtaren që ka vendosur për procedurën e rishikimit, ashtu që edhe këto pretendime si të tilla janë të natyrës supozuese dhe pa asnjë mbështetje të bazuar në ndonjë provë konkrete që do ta vënin në dyshim objektivitetin e këtyre gjyqtarëve.

Kurse sa i përket deklaratimit të personit [L.d.] i cili kishte shkruar një letër që gjendet në shkresat e lëndës gjithashtu nuk paraqet provë të re në interpretim të dispozitës së nenit 423 par.1 nënpar. 1.3 të KPP-së, meqë nga përmbajtja e kësaj shkrese ndonëse e pa verifikuar autencitetin e tekst shkruarit dhe e pa nënshkruar në asnjë rrethanë nuk përbën bazë për rishikim të procedurës penale, por eventualisht mund të paraqet bazë për fillimin e ndonjë hetimi, andaj, meqë provat e propozuara nuk paraqesin prova të reja që do të krijonin bazë për rishikim të procedurës penale, sipas dispozitës së lart cekur e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese, konkretisht të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një Proces të Rregullt) të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës në kërkesën e tyre, theksojnë si në vijim: “Gjykimi i çështjes P.nr. 346/12 të datës 23 Maj 2013 nga gjyqtari – Kryetari i Kolegjit i cili asnjëherë nuk ka punuar si Gjyqtar në Shtetin e Britanisë UK, shih provën F2018/12, e

vulosur dhe vërtetuar nga Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme e Anglisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme të UK, e vërtetuar me vulë Apostile.”

26. Parashtruesit po ashtu në thelb ngritin pretendimin se gjykimi i tyre nuk ishte i drejtë për arsyen se kolegjet në Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme duhet të ishin të përbëra nga gjyqtarët vendor dhe jo nga gjyqtarët ndërkombëtar, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Republikën e Kosovës.
27. Në fund, të njëjtit kërkojnë që të shpallet “i kundërligjshëm” Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme për shkak se i njëjti sipas tyre është “[...] Aktgjykim i paarsyetuar në prova dhe në merita të Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë nga Gjykata Supreme e Kosovës”

Dispozitat relevante të Ligjit dhe Rregullores së punës

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
6. Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E Drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohe nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në

shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

KODI I PËRKOHSHËM PENAL I KOSOVËS **(Publikuar më 6 korrik 2003)**

Neni 23 **(Bashkëkryerja)**

“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepra penale.”

Neni 24 **(Shtytja)**

“Kushdo që me dashje e shtyt tjetrin të kryejë veprën penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë veprën penale, nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e tij.”

Neni 345 **(Ushtrimi i ndikimit)**

*“1. Kushdo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.
[...].”*

Neni 339 **(Shpërdorim i Pozitës Zyrtare ose i Autorizimit)**

“(1) Personi zyrtar i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për tjetrin ose për organizatën e biznesit apo të shkaktimit të dëmit për personin tjetër ose për atë organizatë të biznesit shpërdoron pozitën e tij zyrtare, tejkalon kompetencat ose nuk i përmbush detyrat zyrtare dënohet me burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dëm i cili tejkalon shumën 2.500 euro apo me shkelje të rëndë të të drejtave të personit tjetër, kryerësi dënohet me burgim deri në tri vjet.

(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me dobi pasurore që tejkalon shumën 5.000 euro, kryerësi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.”

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË **KOSOVËS**

Nënkapitulli V - Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Neni 419 **(Mjetet e jashtëzakonshme juridike)**

“1. Procedura penale e përfunduar me aktvendim të formës së prerë ose me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet me kërkesën e personave të autorizuar vetëm

në rastet dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod. Kërkesa për rishikim të procedurës penale i paraqitet gjykatës themelore e cila ka nxjerr vendimin.

2. Pala mund të kërkojë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit. Pala i paraqet kërkesën gjykatës themelore e cila ka nxjerr aktgjykimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

3. Pala mund të paraqesë kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë brenda tre (3) muajsh nga dita kur është dorëzuar aktgjykimin i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë kundër të cilit kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë. Pala paraqet kërkesën në gjykatën themelore e cila ka nxjerr vendimin në shkallë të parë, e cila ia përcjell të gjitha shkresat e lëndës Gjykatës Supreme.

4. Nenet 375, 376, 377, 378 dhe 379 të këtij Kodi zbatohen për të gjitha kërkesat nga ky nen.

Neni 423

(Rishikimi i procedurës penale të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë)

“1. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm nëse:

1.1. provohet se aktgjykimin është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit;

1.2. provohet se aktgjykimin është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

1.3. zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja, të cilat vetë ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimit të tij sipas një dispozite më të butë penale;

1.4. personi për të njëjtën veprë është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për veprë të njëjtë të cilën ka mund ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre; ose

1.5. në rastin e dënimit për veprë penale në vazhdim ose vepra tjera penale të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

2. Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet që rrethanat nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij neni janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose personi që vepron në emër të tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurori të shtetit ose gjyqtari apo të 172 afërmve të tyre, me ç'rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Rishikimi i procedurës penale kundër të pandehurit lejohet vetëm brenda pesë (5) vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimin të formës së prerë.

3. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni, me aktgjykim të formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë a janë shpallur fajtor për veprat penale përkatëse. Kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2. ose paragrafi 2. i këtij neni mund të vërtetohen edhe me prova të tjera.”

Neni 426

(Baza dhe procedura për hedhjen e kërkesës për rishikim të procedurës penale)

“1. Gjykata me aktvendim hedh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të procedurës së mëparshme vërteton se:

1.1. kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;

- 1.2. nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;
 1.3. faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;
 1.4. faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejim të rishikimit të procedurës; ose
 1.5. parashtruesi i kërkesës për rishikim të procedurës nuk ka vepruar sipas nenit 425, paragrafit 2. të këtij Kodi.
 [...]”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet nenit 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113
 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
 (Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
 (Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

31. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesit e kërkesës: (i) janë palë të autorizuar; (ii) kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. Nr. 550/2023], e 17 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktvendimin [PN. nr. 1196/2022], e 20 janarit 2023, të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [PK. Nr. 85/22], e 3 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore; (iii) kanë saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendojnë se iu janë shkelur; (iv) kane shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe (v) e kane dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
32. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësojë plotësimin e kritereve të përcaktuara përmes pikës b të paragrafit 3 të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, sipas të cilës, Gjykata mund të konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
33. Në këtë kontekst, Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e këtij rregulli si në vijim:
- (3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:
- [...]
- (b) Kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;
34. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me refuzimin e kërkesës së parashtruesve për rishikim të procedurës penale. Në vitin 2013, me Aktgjykim të Gjykatës Themelore, i cili mori formë të prerë në vitin 2016, parashtruesit e kërkesës ishin dënuar me dënim unik secili me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet e 6 (gjashtë) muaj. Më 5 janar 2022, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për rishikimin e procedurës së lartcekur penale, e cila kërkesë u hodh poshtë nga Gjykata Themelore më 11 maj 2022, me arsyetimin se ishte e pasafatshme. Sipas ankesës së parashtruesve, Gjykata e Apelit më 10 qershor 2022, ktheu çështjen në rivendosje. Në procedurë të rivendosjes, më 3 nëntor 2022, Gjykata Themelore refuzoi kërkesën për rishikim të procedurës penale të parashtruesve në merita, i cili aktvendim u vërtetua nga gjykatat e rregullta, respektivisht, edhe nga Gjykata e Apelit më 20 janar 2023, si dhe Gjykata Supreme më 17 nëntor 2023 përmes Aktgjykimit të kontestuar.
35. Sa i përket thelbit të kërkesës së parashtruesve lidhur me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton se ata pretendojnë se iu është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për faktin se (i) janë gjykuar nga një gjyqtar ndërkombëtar, i cili sipas tyre nuk ka qenë asnjëherë gjyqtar në shtetin prej nga vjen, dhe se (ii) kolegjet në Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme ishin përbërë nga gjyqtarët ndërkombëtar dhe jo vendor siç e kërkonte legjislacioni në fuqi.
36. Gjykata vë në pah se gjykatat e rregullta në procedurën sipas kërkesës për rishikim të procedurës penale vendosin vetëm lidhur me çështjen nëse kërkesa për rishikim të procedurës penale plotëson kushtet procedurale për miratimin e saj, dhe jo për “*ndonjë aktakuzë*” të parashtruesit të kërkesës brenda kuptimit të së drejtës për gjykim të drejtë të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (shih në mënyrë analoge rastet e Gjykatës: Gjykatës [KI07/17](#), me parashtrues *Pashk Mirashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 majit 2017, paragrafi 66; [KI06/18](#), me parashtrues *Shkumbin Mehmeti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 55; [KI50/18](#), me parashtrues *Deljalj Kazagić*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafi 51; [KI76/18](#), me parashtrues *Pjetër Boçi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 69; [KI63/21](#), me parashtrues *Hysen Metahysa*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 nëntorit 2021, paragrafi

- 72; dhe [KI34/23](#), me parashtrues *Veton Syla*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafët 48 dhe 49; dhe rastet e GJEDNJ-së: [Bochan kundër Ukrainës, \(nr. 2\)](#), nr. 22251/08, Aktgjykim i 5 shkurtit 2015, paragrafi 44 dhe [Moreira Ferreira kundër Portugalisë \(nr. 2\)](#), nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafët 60-61).
37. Përveç kësaj, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-se, e cila përcakton se neni 6 i KEDNJ-se nuk është i zbatueshëm në procedurat për përsëritjen e ndonjë rasti, sepse nëse një person dënimi i të cilit është bërë i plotfuqishëm dhe i cili bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe ai ose ajo gjatë kësaj procedure nuk është "*i akuzuar për ndonjë vepër penale*" në kuptim të nenit 6 të Konventës (shih rastin e GJEDNJ-së, [Fischer kundër Austrisë](#), nr. 27569/02, Vendim mbi pranueshmërinë e rastit, i 6 majit 2003).
38. Më tej, Gjykata vëren se lidhur me kërkesën për rishikim të procedurës penale, të parashtruar nga parashtruesit e kërkesës, gjykatat e rregullta kishin vendosur për refuzimin e saj.
39. Gjykata, pikërisht duke pasur parasysh këtë pretendim të parashtruesve të kërkesës në kontekstin e garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, konstaton se procedura gjyqësore e përmendur në të cilën parashtruesit i bazojnë pretendimet e tyre ankimore kishte të bënte vetëm me vlerësimin e përmbushjes së kërkesave procedurale të cilat duhet t'i përmbushë një kërkesë për rishikim të procedurës penale, në mënyrë që të jetë e pranueshme, dhe kështu rasti do të rihapej për shqyrtim dhe vlerësim në procedurën e përsëritur.
40. Prandaj, duke pasur parasysh përmbajtjen e procedurës gjyqësore në të cilat parashtruesit i kanë mbështetur pretendimet e tyre ankimore për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata rikujton edhe një herë praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e vet gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës, qoftë penale apo civile (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës: [KI07/17](#), *Pashk Mirashi*, cituar më lart, paragrafi 64 [rishikim i procedurës penale]; [KI80/15](#), [KI81/15](#) dhe [KI82/15](#), *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31 [përsëritje e procedurës përmbarimore]; [KI86/22](#), parashtrues *Pjetër Boçi*, cituar më lart, paragrafi 77 [rishikim i procedurës penale]; [KI167/22](#), parashtrues *Fatos Kakeli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 marsit 2023, paragrafi 63 [përsëritje e procedurës civile]; [KI34/23](#), parashtrues *Veton Syla*, cituar më lart, paragrafi 52 [rishikim i procedurës penale]; shih, gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, [Oberschlick kundër Austrisë](#), nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, [Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011).
41. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me procedurën gjyqësore të zhvilluar nga gjykatat sipas kërkesës së tyre për rishikimin e procedurës penale shpallet e papranueshme, për shkak se është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën, siç përcaktohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 34 (3) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (3) (b) si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtare raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani